

KËRKESË
Nr.4275/2, datë 11.7.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Rrëshen”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ju bëjmë me dije që vlerësimi i objekteve është bërë në bazë të zërave të punimeve të evidentuara dhe të dokumentuara në prezencë të pronarëve, të cilët kanë firmosur më pas procesverbalet respektive. Ndërsa çmimet për çdo zë punimi janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, kjo në mbështetje të akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik”.

Të gjithë pronarët, për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, janë bërë shënime “I pakonfirmuar”, “I paregjistruar” dhe “I pakonfirmuar për objekt” duhet të aplikojnë për regjistrimin e objekteve që posedojnë. Këta pronarë do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”).

Pronarët për të cilën në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 22 382 697 (njëzet e dy milionë e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

LISTA E OBJEKTEVE, NË PRONËSI PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT MILOT-RRËSHEN

Nr	Lloji i objektit	Emri i pronarit	Nr.pasurisë	Segmenti	Vlera Lekë	Shënime
1	Shtëpi 1-kt	Franc Preng Jaku	3/40	Milot-Rrëshen	2332942	Konfirmuar nga ZRPP
2	Servis	Gjin Pjetër Çerri	45/45	Milot-Rrëshen	207544	Konfirmuar nga ZRPP
3	Servis	Ndue Jaku		Milot-Rrëshen	418957	I pakonfirmuar
4	Shtëpi 1-kt	Fejzulla Saraçi	3/111	Milot-Rrëshen	3030097	Konfirmuar nga ZRPP
5	Shtëpi 3-kt	Pjetër Ndue Preçi	3/20	Milot-Rrëshen	4155307	Konfirmuar nga ZRPP
6	Shtëpi 1-kt	Ded Shan Kola	1/104	Milot-Rrëshen	3215162	Konfirmuar nga ZRPP
7	Magazinë	Ismet Veseli		Milot-Rrëshen	164719	I paregjistruar
8	Shtëpi 1-kt	Adem Xhafer Lika	40/16/1	Milot-Rrëshen	835406	Konfirmuar nga ZRPP
9	Shtëpi 1-kt +magazinë	Vlash Ded Gega	1/46, 1/82	Milot-Rrëshen	6909857	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bar-bufë	Ndue Kol Zambaku		Milot-Rrëshen	731565	I pakonfirmuar
11	Shtëpi 1-kt	Lek Nikoll Fusha		Milot-Rrëshen	381141	I pakonfirmuar për objekt
		TOTALI			22382697	